

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE TIRANE  
NR-1592-REP  
NR-267-KOL



**KONTRATE SHITJE AKSIONESH**

**Ne baze te nenit 705 te K.Civil**

Sot me datë 08.05.2006 (dymije e gjashtë), ditën e hënë, para meje **Noteres Tamara MALAJ**, Notere në Dhomën e Noterisë Tiranë, me seli në Rr. "L.Gurakuqi" P2, u paraqitën personalisht :-----

**SHITESI: Z. FAIK BRUÇI** i biri Ramadan dhe Nafije lindur në Dibër më 01.01.1956 banues në Tiranë Rr. "Q.Stafa" pall 12kat, i paisur me pasaportën me nr 20318284.-- -- -

**BLERESI: "SHOQERIA EURO-ALBA-EA"** shpk e regjistruar si person juridik me Vendimin e Gjykatës Rrethit Tirane me nr 8724/10 të datës 30.12.2005, e perfaqësuar nga Z Gazmen NEZA, i biri Hazir dhe Have, lindur në Kukës më 11.07.1972 banues në Durres i paisur me pasaportën Z 0731695:Te lartpermendurit janë madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar të cilet deklaruan se lidhin kontratën e shitblerjes se kuotes se kapitalit si vijon:- -


Shitësi **FAIK BRUÇI** është aksioner në kuotën prej 12 % në kapitalin e Shoqërisë Anonime "EUROSIG" e regjistruar si person juridik me Vendimin nr 31954/5 të dt 29.12.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i ndryshuar me Vendimin nr 31954/6 të dt 20.03.2006 të kësaj Gjykate. Me vendimin nr 3 të dt 05.05.2006 të Asamblesë së aksionerëve, Aksionerët e kësaj shoqërie kanë pranuar kërkesën e Z. FAIK BRUÇI për tu larguar nga shoqëria duke transferuar kuotën e tij të kapitalit përmes shitjes së aksioneve, në Shoqërinë "EURO-ALBA-EA" SHPK me Ortak të vetëm Z. Gazmen NEZA. Për 12% të aksioneve, në kapitalin e Shoqërisë së Sigurimeve që ka aksioneri Faik Bruçi është dakort t'ia shesë Blerësit Shoqërisë "EURO-ALBA-EA" Shpk. Me vullnetin e tij të lirë e të plotë shitësi FAIK BRUÇI deklaroi se kuotën e tij në kapitalin e shoqërisë "EUROSIG" Sha, prej 12% është dakort t'ia shesë Blerësit SHOQERIA "EURO-ALBA-EA" shpk, e perfaqësuar nga ortaku i vetëm Gazmen NEZA. Në marrëveshje të përbashkët cmimi i shitjes së kësaj kuote të kapitalit të kësaj shoqërie është caktuar në vlerën 12.000.000 lekë (dymbëdhjetë milion), shumë kjo që është likuajduar nga pala Blerëse plotësisht jashtë kësaj zyre. Edhe Blerësi deklaroi se pranon të blejë kuotën e mësipërme të aksioneve, në cmimin e caktuar në marrëveshje të përbashkët, vlerë kjo që është likuajduar jashtë kësaj zyre.- - - -

Me nënshkrimin e këtij akti noterial pala shitëse e humbet të drejtën e pronësisë mbi aksionet e shoqërisë « EUROSIG » SH A, duke transferuar në këtë mënyrë të gjitha të drejtat dhe detyrimet tek Blerësi SHOQERIA "EURO-ALBA-EA" e perfaqësuar nga Gazmen NEZA i cili bëhet aksioner në kuotën prej 12 % në kapitalin e kësaj shoqërie pas depozitimit në Gjykatë të këtij akti noterial. Përsa i përket aksionereve të tjerë të kësaj shoqërie ata ruajnë kuotën që kanë patur, kështu Xhevdet MORINA ruan kuotën 4%, Gezim BALISHA ruan kuotën 3%, Damian GJIKNURI ruan kuotën 3% dhe Myslym NELA zotëron kuotën 3%.-- -- -


Me hartimin e kësaj kontrate shitësi **FAIK BRUÇI** e humbet të drejtën e bashkëpronësisë në **SHA « EUROSIG »**, dhe bashkëpronarë në këtë shoqëri në kuotën e përcaktuar më sipër, mbeten **Kadri MORINAJ** në kuotën 75% dhe aksionerët e tjerë, **Xhevdet MORINA** 4%, **Gezim BALISHA** 3%, **Damian GJIKNURI** 3% dhe **Myslym NELA** 3%; pra ata ruajnë kuotën që kanë patur më parë. Ky akt noterial për të sjellë efektet ligjore duhet të depozitohet në regjistrin tregëtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në bazë të Ligjit nr 7767 dt 28.01.1993 dhe Ligjit nr 7829 dt 06.06.1994.-----

Për të vërtetuar sa me sipër, u hartua prej meje Noteres kjo kontratë Shit-Blerje e kuotave të kapitalit në shoqerine aksionere, e cila pasi u lexua nga palët, dhe u gjet sipas vullnetit të tyre, u nënshkrua në praninë time sipas ligjit, dhe unë Noterja e vërtetoj atë rregullisht.---

SHITESI  
FAIK BRUÇI



BLERESI  
SHOQERIA "EURO-ALBA-EA" shpk  
Perfaqësuar nga **GAZMEN NEZA**



NOTERE

TAMARA

MALAJ

NOTERE  
TAMARA MALAJ  
Rr. L. GUKAKU 01, P.2. AP. 21  
TIRANE  
TEL. 7 08 25



TAKSA E PULLES  
U PAGUA



**KONTRATE SHITJE AKSIONESH**

**Ne baze te nenit 705 te K.Civil**

Sot me datë 09.05.2006 (dymije e gjashtë), ditën e marte, para meje **Noteres Tamara MALAJ**, Notere në Dhomën e Noterisë Tiranë, me seli në Rr. "L.Gurakuqi" P2, u paraqitën personalisht :-----

**SHITESI: Z.GEZIM BALISHA** i biri Bajram dhe Gjyle lindur ne Tropoje më 14.01.1962 banues në Tiranë Rr."M.Tutulani" pall Bankes nr 2, i paisur me pasaporten me nr Z103390.-- -- -

**BLERESI: XHEVDET MORINA** i biri i Tahir dhe Hyre lindur ne Kukes me 29.12.1967, banues ne Tirane Bulevardi „Zogu i I,, i paisur me pasaporten me nr Z 0323038.---

Te lartpermendurit jane madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar te cilet deklaruan se lidhin kontraten e shitblerjes se kuotes se kapitalit si vijon:- -

Shitësi **GEZIM BALISHA** është aksioner në kuotën prej 3 % në kapitalin e Shoqërisë Anonime "EUROSIG" e regjistruar si person juridik me Vendimin nr 31954/5 të dt 29.12.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i ndryshuar me Vendimin nr 31954/6 të dt 20.03.2006 te të kesaj Gjykate. Me vendimin nr 3 te dt 05.05.2006 te Asamblesë se aksionerëve, Aksionerët e kësaj shoqërie kanë pranuar kërkesen e Z. **GEZIM BALISHA** për tu larguar nga shoqëria duke transferuar kuotën e tij te kapitalit përmes shitjes se aksioneve, aksionerit **XHEVDET MORINA**, pra 3% te aksioneve, ne kapitalin e Shoqërise se sigurimeve qe ai ka ne pronesia shese aksionerit Z **XHEVDET MORINA**. Me vullnetin e tij te lire e te plote shitësi **GEZIM BALISHA** deklaroi se kuotën e tij ne kapitalin e Shoqërise "EUROSIG" Sha, prej 3% eshte dakort tia shese bleresit **XHEVDET MORINA**. Në marrëveshje të përbashkët cmimi i shitjes së kësaj kuote të kapitalit të kësaj shoqërie është caktuar në vlerën 3.000.000 lekë (tre milione), shumë kjo që është likujduar nga pala Blerëse plotësisht jashtë kësaj zyre. Edhe Blerësi **XHEVDET MORINA** deklaroi se pranon të blejë kuotën e mësipërme të aksioneve, në cmimin e caktuar ne marrveshje të përbashkët, vlerë kjo që është likujduar jashtë kësaj zyre. - - - -

Me nënshkrimin e këtij akti noterial pala shitëse e humbet të drejtën e pronësisë mbi aksionet e shoqërisë « **EUROSIG** » SH A, duke transferuar në këtë mënyrë të gjitha të drejtat dhe detyrimet tek Blerësi **XHEVDET MORINA** i cili bëhet aksioner në kuotën prej 7 % në kapitalin e kësaj shoqërie pas depozitimit në Gjykatë të këtij akti noterial. Përsa i përket aksionereve të tjerë të kësaj shoqërie ata ruajnë kuotën që kanë patur, kështu **KADRI MORINAJ** ruan kuotën 75%, Shoqëria "EUROALBA-EA" SHPK ruan kuotën prej 12%, **Damian GJIKNURI** ruan kuotën 3% dhe **Myslym NELA** zotëron kuotën 3%. - - -

Me hartimin e kesaj kontrate shitesi **Gezim BALISHA** e humbet te drejten e bashkepronese ne **SHA « EUROSIG »**, dhe bashkepronaret e kesaj shoqerie ruajn kuoten e percaktuar me siper. Ky akt noterial per te sjelle efektet ligjore duhet te depozitohet ne regjistrin tregetar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane ne baze te Ligjit nr 7767 dt 28.01.1993 dhe Ligjit nr 7829 01.06.1994.-----

Per te vertetuar sa me siper, u hartua prej meje Noteres kjo kontrate Shit-Blereje e kuotave te kapitalit ne shoqerine aksionere, e cila pasi u lexua nga palet, dhe u gjet sipas vullnetit te tyre, u nenshkrua ne pranine time sipas ligjit, dhe une Noterja e vertetoj ate rregullisht.---

**SHITESI**

**GEZIM BALISHA**

**BLERESI**

**XHEVDET MORINA**

*Xhevdet Morina*

**NOTERE**

**TAMARA MALAJ**

**TAKSA E PULLES  
U. PAGUA**

**NOTERE**  
**TAMARA MALAJ**  
Rr. L. GURAKUQI, P.2. AP. 21  
TIRANE  
TEL. 2 08 25